



---

**UNIVERSITETI I TIRANËS**  
**SENATI AKADEMIK**

**VENDIM**

**Nr.12, datë 06.07.2017**

**“Mbi disa modalitete në lidhje me procedurat e pranimit dhe regjistrimit të studentëve në Universitetin e Tiranës për vitin akademik 2017-2018”**

Bazuar në ligjin nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në RSH” në nenin 3, nenin 25 pika 8, nenin 33 pika 3, nenin 38 pika 1 gërmat a) dhe d) dhe pika 3, nenin 74 pika 3, nenin 76 pika 6; Statutin e Universitetit të Tiranës në nenin 19 dhe nenin 20, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës, në mbledhjen e datës 06.07.2017;

**VENDOSI:**

1. Ngritjen e një grupi pune për hartimin e rregullores së pranimit dhe regjistrimit të studentëve në Universitetin e Tiranës për vitin akademik 2017-2018, me përbërje: një përfaqësues të propozuar nga secili fakultet dhe një përfaqësues student anëtar i Senatit Akademik.
2. Kryerjen me një raund të procesit të pranimit dhe të regjistrimit të studentëve në Universitetin e Tiranës për vitin akademik 2017-2018.
3. Kryerjen e regjistrimit të kandidatëve fitues në Universitetin e Tiranës me dokumentacionin (deftesë/diplomë) origjinal.
4. Njohjen e të drejtës kandidatëve fitues për t'u çregjistruar në çdo kohë nga programi ku do të jenë regjistruar si fitues.
5. Proçesi i pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve fitues në Universitetin e Tiranës të fillojë më datën 04.09.2017.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**PROF. DR. MYNYR KONI**